



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 123 Prot.

Tiranë, më 13.04 2021

**Lënda:** Përcillet denoncimi i qytetarit M.E

**STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË  
ORGANIZUAR**

**PROKURORISË SË TIRANËS**

**ORGANEVE DREJTUESE TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Për dijeni:**

**OSBE/ODIHR**

**MISIONI I LIMITUAR PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE**

**PRANIA E OSBE-SË NË SHQIPËRI**

**DELEGACIONI I BASHKIMIT EVROPIAN NË SHQIPËRI**

**AMBASADA E SHTETËVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS**

**AMBASADA BRITANIKE**

**Tiranë**

Pas nismës së bërë publike nga Presidenti i Republikës, ku u kërkohet qytetarëve të denoncojnë çdo parregullsi në lidhje me kryerjen e krimeve elektorale gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, pranë Institucionit të Presidentit të Republikës është administruar, mes të tjerash, në rrugë elektronike shqetësimi i një qytetari, i cili ka paraqitur denoncimin e tij kundrejt punësimeve masive gjatë periudhës zgjedhore në [REDAKTUAR]

Sipas ankesës, qytetari bën me dije se, [REDAKTUAR] në datën 06.04.2021 që përkon me kohën e periudhës së fushatës zgjedhore, [REDAKTUAR] ritet të fillojnë [REDAKTUAR] njëherësh, edhe pse nuk janë kushtet për shkak se Instituti i Ndërtimit e ka nxjerrë godinën të pabanueshme, si rezultat i tërmetit të vitit 2019.

Bashkëlidhur gjeni kopjen e denoncimit të administruar, me kërkesën për verifikim të rastit, si dhe ruajtjen e anonimatit të denoncuesit për aq sa e lejon legjislacioni në fuqi.